



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 591, datë 13.10.2021

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.307,  
DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN  
E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT  
DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE  
NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
  - a) Në pikën 3.1, shifra "... 1 611 987 454 (një miliard e gjashtëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) ..." zëvendësohet me shifrën "... 1 831 788 178 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) ...".
  - b) Në shkronjën "b", të pikës 3.1, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Shifra "... 434 365 277 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) ..." zëvendësohet me shifrën "... 654 166 001 (gjashtëqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e një) ...".

ii. Në fund të shkronjës "b" shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Efekti financiar shtesë do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit të projekteve me ecuri të ngadaltë."

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 4776/1  
DATE 14.10.2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË  
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKISË TIRANË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

